


UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-04/05

Prishtinë, më 23 shkurt 2005

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Fatmir Sejdiu**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, kurse e ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryesuesi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm **101 deputetë** dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miratimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe të Përvetësimeve për periudhën kohore prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2005;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/2 për menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësiive”;
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për verërat;
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lirinë e asociimit në OJQ;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet sociale dhe familjare;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës;
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për banim dhe
9. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e gjyqtarëve.

Në fillim të seancës, kryesuesi u dëshiroi mirëseardhje deputetëve të posacertifikuar: **Sadudin Berisha, Ymer Halimi, Mazllum Kumnova, Sasha Gjokiq dhe Ferid Agani.**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

Jakup Krasniqi, në emër të PDK-së, kërkoj që në seancën e sotme të diskutohet për reformimin e pushtetit vendor në Kosovë.

Ai i paraqiti qëndrimet e Grupit Parlamentar të PDK-së lidhur me Programin e Qeverisë së Kosovës për reformimin e pushtetit vendor, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryesuesi tha se Kryesia e Kuvendit e ka miratuar kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së që çështja e reformimit të pushtetit vendor të shqyrtohet në Kuvend. Por, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës ta përgatitë materialin bazë për diskutim, që do t'u shpërndahet deputetëve dhe në seancën e parë të radhës do të shqyrtohet kjo çështje.

Veton Surroi, në emër të Grupit Parlamentar ORA, kërkoj të formohet një komision hetimor lidhur me shpenzimet e buxhetit gjatë dhjetorit të 2004.

Për reformimin e pushtetit vendor duhet të miratohen ligje përkatëse, në procedurë të rregullt parlamentare. Ajo duhet të jetë pjesë e reformës së tërësishme të sistemit kushtetues, e cila nënkupton miratimin e një kushtetutës të re të Kosovës.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së tha e mbështesin nismën për shqyrtimin e reformimit të pushtetit vendor, por kërkojmë që materiali i përgatitur nga Qeveria t'u shpërndahet deputetëve dhe pastaj të diskutohet.

Lidhur me kërkesën për formimin e komision hetimor, ne mendojmë se Komisioni për Buxhet dhe Financa duhet të organizojë dëshmi me ministrin për Financa dhe raportin e asaj dëshmie t'ia paraqes Kuvendit. Nëse rezultatet nuk janë të kënaqshme, atëherë do ta mbështesim formimin e komisionit hetimor.

Në vazhdim seancën e kryesoi Naim Maloku, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Hashim Thaçi, në emër të Partisë Demokratike, kërkoj që Kuvendi ta caktojë datën e mbajtjes së seancës plenare, në të cilën do të shqyrtohet reformimi i pushtetit vendor

Kryesuesi tha se Qeveria e Kosovës dje e ka miratuar Programin për reformimin e pushtetit vendor, i cili do t'i procedohet Kuvendit dhe do t'u shpërndahet deputetëve, kurse grupet parlamentare dhe Kryesia do të marrin qëndrim për ditën kur do të mbahet debati lidhur me këtë çështje.

Deputetët e Grupit Parlamentar të PDK-së, në shenjë pakënaqësie për mos pranimin e kërkesës për ta shqyrtuar reformimin e pushtetit vendor, e lëshuan seancën.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miratimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe të përvetësimeve për periudhën kohore prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2005

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Funkcional.

Ai i hodh në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit të Buxhetit dhe Financave, të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe të Qeverisë së Kosovës.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19 dhe 20, kurse nuk e miratoi amendamentin 18.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----73;
Kundër----- 0;
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash e **miratoi** Ligjin për buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe të përvetësimeve për periudhën kohore prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2005.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/2 për menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësi

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Funkcional.

Ai i hodh në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit të Buxhetit dhe Financave

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2 dhe 3.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----75;
Kundër----- 0;
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi** Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/2 për menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësi.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për verërat

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Funkcional.

Ai i hodh në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari...dhe të Komisionit të Buxhetit dhe Financave.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28 dhe 30, kurse nuk i miratoi amendamentet 1 dhe 29.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----70;
Kundër----- 7;
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash e **miratoi** Ligjin për verërat.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lirinë e asocimit në OJQ

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Funkcional.

Ai i hodh në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shërbime Publike...dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 2, 3, 4, 6, 8, 10, 11(a), 13 dhe 14, kurse nuk i miratoi amendamentet 1, 5, 7, 9, 11(b) dhe 12.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----70;
Kundër----- 6;
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash e **miratoi** Ligjin për lirinë e asocimit në OJQ.

Kryesuesi dha pauzë dreke.

Pas pauzës, seancën e drejtoi **Fatmir Sejdiu**, anëtar i Kryesisë.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet sociale dhe familjare

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Ahmet Isufi, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri Isufi tha se me këtë projektligj Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale merr përgjegjësinë për organizimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë, si dhe për zhvillimin e politikave dhe të planeve strategjike për këtë fushë.

Me këtë projektligj parashihet formimi i këshillit të përgjithshëm, i cili do të jetë përgjegjës për licencimin e profesionistëve të kësaj fushe, për hartimin e kodit të etikës për profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare.

Parashihet mbrojtja e fëmijëve, në harmoni me konventat ndërkombëtare.

Qendrat për punë sociale mbajnë të drejtën e mbrojtjes emergjente, duke pasur parasysh edhe largimin e fëmijëve nga familja apo rrethi ku jetojnë, por janë të obliguara që rastin ta paraqesin në gjykatë dhe nëse ajo vlerëson se fëmija ka nevojë për mbrojtje, atëherë ajo është e autorizuar të nxjerrë urdhër kujdestarie.

Parashihet edhe mbrojtja e të rriturve, të cilëve u mungon aftësia e veprimit. Në këto raste, qendrat për punë sociale janë të obliguara që pas evidencimit të rasteve t'i drejtohen gjykatës për urdhër kujdestarie dhe strehim eventual.

Ky projektligj ,pos tjerash, shton shkallën profesionale dhe i obligon nëpunësit e shërbimeve për ruajtjen e konfidencës.

Në fund, ministri Isufi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Naim Jerliu, Zylfije Hundozi, Fatmire Kollçaku, Shpresa Murati, Gjergj Dedaj, Nafije Berisha, Milazim Haliti, Ramadan Kelmendi dhe Fetah Berisha**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----73;

Kundër----- 1;

Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për shërbimet sociale dhe familjare. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale – komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Bajram Kosumi, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me një ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri Kosumi tha se në Kosovë kemi shembullin e dytë të bifurkacionit në botë, pas atij në Amerikën Jugore, atë të lumit të Nerodimes, kemi Shpellën e Gadimës, me sipërfaqen më të madhe të mermertë në botë, Kanionin atraktiv të Mirushës, që është i dytë në rajon, si dhe simbolin emblemantik të biodiversitetit të Kosovës - Parkun Kombëtar Malet e Sharrit.

Struktura e këtij projektligji është e radhitur në 12 kapituj dhe e zbërthyer në 45 nene.

Kapitulli i parë, përmban dispozitat e përgjithshme të mbrojtjes së natyrës, ku përfshihen qëllimet e ligjit, raportet e tij me ligjet e posaçme.

Kapitulli i dytë, përmban definicionet kryesore, që janë në përputhje me direktivat evropiane dhe me dispozitat e Unionit Botëror të Ruajtjes së Natyrës.

Kapitulli i tretë përmban parimet themelore të mbrojtjes së natyrës, duke u bazuar mbi parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të Samitit të Rios – 92 dhe të atij të Johannesburgut 2002.

Kapitulli i katërt parasheh dokumentet kryesore për mbrojtjen e mjedisit si: strategjia dhe plani i veprimit për mbrojtjen e natyrës dhe programet e mbrojtjes së natyrës, që do të nxirren nga komunat për territorin e tyre.

Kapitulli i pestë përcakton organet përgjegjëse për mbrojtjen e natyrës, duke bërë një ndarje ndërmjet kompetencave të nivelit qendror dhe të atij lokal.

Kapitulli i gjashtë përmban masat e përgjithshme për mbrojtjen e visoreve natyrore, masat për mbrojtjen e specieve të florës dhe faunës.

Kapitulli i shtatë përmban masat e veçanta për mbrojtjen e natyrës.

Kapitulli i tetë, përmban dispozitat për mbrojtjen e specieve të rralla të florës dhe të faunës.

Kapitulli i nëntë, përmban dispozitat e mbikëqyrjes së drejtpërdrejt të zbatimit të ligjit nga Inspektorati për Mbrojtjen e Natyrës.

Kapitulli i dhjetë, rregullon financimin e punëve për mbrojtjen e natyrës, kryesisht përmes buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe Ekofondit.

Kapitulli i njëmbëdhjetë, përmban dispozitat ndëshkimore, në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji.

Në fund, ministri Kosumi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Lulzim Zeneli, Gjynaze Syla, Gazmend Muhaxheri, Xhezair Murati, Zyhrije Maloku, Numan B aliq, B rikenda K ryeziu, K amber Kamberi dhe F etah B erisha**, që i janë bashkangjitur transkriptim.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----67;

Kundër----- 1;

Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e natyrës. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor...- komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për banim

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Bajram Kosumi, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri Kosumi e shpjegoi strukturën e këtij projektligji e radhitur në 16 kapituj dhe 156 nene.

Kapitulli i parë, përmban dispozitat e përgjithshme.

Kapitulli i dytë, përcakton institucionet përgjegjëse për banim, që përfshin përgjegjësitë e Ministrisë dhe të komunave në fushën e banimit.

Kapitulli i tretë, përmban dokumentet për banim, që përfshin raportin qendror për banim, strategjinë e banimit në Kosovë, programet për banim, strategjinë dhe programet komunale të banimit.

Kapitulli i katërt, përcakton mënyrën e financimit të banimit.

Kapitujt pesë dhe gjashtë, rregullojnë raportet pronësore-juridike në ndërtesën shumëkatëshe për banim dhe administrimin e tyre.

Kapitujt shtatë dhe tetë, rregullojnë raportet në mes pronarëve dhe personave të tretë, si dhe formimin e bashkësisë së pronarëve.

Kapitulli i nëntë, përcakton mënyrën se si mund të shfrytëzohet ankesa.

Kapitulli i dhjetë, rregullon raportet e banesave qiramarrëse, llojet e banesave me qira, elementet e kontratës për qira, të drejtat dhe detyrimet tjera qiramarrëse e qiradhënëse.

Kapitulli i njëmbëdhjetë, përcakton mënyrën e caktimit të qirasë.

Kapitulli i dymbëdhjetë, rregullon raportet e banesave joprofitabile me qira.

Kapitulli i trembëdhjetë, rregullon shpengimin dhe privatizimin e banesave.

Kapitulli i katërmëdhjetë, rregullon mbikëqyrjen inspektive.

Kapitulli i pesëmbëdhjetë, përcakton kundërvajtjet dhe gjobat për shkelësit e dispozitave të këtij ligji, dhe

Kapitulli i fundit përcakton dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Në fund **ministri Kosumi** dha informata shtesë lidhur me deklaratën financiare, e cila ndryshonte nga e mëparshmeja, si dhe buxheti i kësaj ministrie mundësonte zbatimin e këtij projektligji.

Ai i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Isuf Sutaj, Myrvete Dreshaj, Nazim Jashari, Mahir Jakxhilar, Zllatica Kujunçiq, Numan Baliq, Ramadan Kelmendi, Sabit Rrahmani, Sabri Hamiti dhe Rrustem Ibishi**, që i janë bashkangjitur transkriptim.

Ministri Kosumi iu përgjigj vërejtjeve të deputetëve.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 73;
Kundër----- 0;
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për banim. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor...– komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

9. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Gjqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e gjyqtarëve

Kuvendi, pas shqyrtimit të këtij rekomandimi, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet rekomandimi i Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës që z. Hamdi Podvorica, të emërohet gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës.
2. Rekomandimi i parashtrohet PSSP-së, për veprim përfundimtar.

Kryesuesi e deklaroi seancën të mbyllur në orën 15:15 minuta.

Përgatitur nga

Spektori për Çështje Plenare dhe Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Akademik Nexhat DACI
